

Florian Vlasi I: nga Shqipëria ne Spanje

Paco Yáñez

Recomendar 141

2

E-MAIL

IMPRIMIR

COMENTARIOS



Florian Vlasi

Violinisti dhe dirigjenti shqiptar Florian Vlasi (Durrës 1963) është, që prej gati njëzet vitesh, një nga vlerat kryesore të muzikës bashkohore në Galicia, vendi i tij i adoptimit që nga viti 1992 kur hyri në Orquesta Sinfónica de Galicia. Në A Coruña, Florian Vlasi drejton Grupo Instrumental Siglo XX, një ansambël i formuar kryesisht nga solistët e orkestrës herkuline me të cilët luan një repertor të gjerë që ka në bazë kryeveprat e shekullit XX ku përfshihen autorë që nga Schönberg, Xenakis, Stravinsky apo Crumb e deri tek Bartók, Schnittke e shume të tjerë gjithmonë brenda këtij organizmi të jashtzakonshëm që është muzika bashkohore.

Një tjetër bosht kryesor i GISXX është mbështetja e repertorit të muzikës së re të Galicias, një fushë kjo ku grupi i Florian Vlashit ka qenë referenca kryesore në keto vitet e fundit. Linjat estetike që Vlasi ndjek për të përcaktuar muzikën kulte në Galicia e kanë çuar deri aty sa të rizbulojë autorë galegë të shekullit të kaluar, si Manuel Quiroga apo Andrés Gaos (nga i cili, me 1999 nxorri në treg një CD me veprën complete për violinë e piano të këtij autori). Për sa i përket repertorit aktual, Vlasi dhe grupi i tij GISXX i kanë dhënë skenës numrin më të madh të premierave të autorëve bashkohorë, më shumë se çdo grup tjetër, duke punuar mbi partiturat e krijuesve si Juan Vara, Jorge Berdullas del Río, Fernando Buide, Manuel Balboa, Rudesindo Soutelo etj. Një karrierë artistike kjo që e ka njohur dhe nderuar Asociación Galega de Compositores, duke e emëruar “socio protector”.

Si violinist i repertorit bashkohor, Florian Vlasi ka luajtur në programet e qendrave si Reina Sofía, Fundación Juan March apo Auditorio Nacional në Madrid, po ashtu edhe në shume festivale në Spanje apo në Europë. Ka bashkëpunuar me Plural Ensemble te Madridit si dhe është krijues dhe drejtues që nga viti 2003 i Festivalit “Netet e Muzikës Klasike” në qytetin e tij të lindjes Durrës.

Paco Yáñez. Tërheq vëmendjen, brenda këtij kryqezimi apo arqipelagu të madh –duke ndjekur imagjinatën e Massimo Cacciari– që është Europa, ardhja e një violinisti nga një vend si Shqipëria deri ketu në perëndimin europian, në A Coruña. Si ishte, në rastin tuaj, kjo rrugë e gjatë përmes kontinentit?

Florian Vlasi. Historia ime është thajse po ajo e mijrave muzikanteve që levizin sot neper bote. Mendoj se të gjithë ne kemi “sindromën e trubadureve” të cilët udhëtonin në distanca të mëdha. Në oborret mbretërore në sh. XVII e XVIII kishte muzikantë nga Italia, Gjermani, Franca etj. Dhe kjo levizje vazhdon nëse edhe sot. Ndryshimi është se, në vend që të informohemi nga një leter me vula mbretërore, sot shikojmë konkurset në Internet dhe udhetojmë me avionë...

Une u lajmërova “*alla antiqua*”, me shkrim; një miku im nga Zvicëra më dergoi një leter të cilën akoma e ruaj, ku më informonte mbi konkursin për Orquesta Sinfónica de Galicia që zhvillohej gjatë muajit shkurt 1992 në Stuttgart, Londër, Nju Jork, Bratislavë, San Petersburg dhe A Coruña. E pranova menjëherë. Mora pará hua për të konkuruar në Stuttgart. Udhëtova me traget nga Durrësi për në Trieste. Më kujtohet shume mirë që kishte shume dallge dhe une studjoja në gabinën e anijes. Duhej ta fitoja këtë konkurs! Kurrë nuk do ta harroj atë udhëtim duke i rënë violines me levizjen e dallgeve. Si tek skena e famshme tek filmi i Tornatores *Legjenda e pianistit të oqeanit* kur ai heq frenat e rrotave të pianos dhe luan e luan ndërsa dallget levizin pianon neper gjithë sallen, duke “vallezuar” me oqeanin. Një skenë e rrallë... Në rastin tim ishte tjetër gjë. Nuk ishte një vallezim. (Mbase po). Por pata një parandjenjë se ajo që më priste nuk do ishte një udhëtim i lehtë...

Kur Maximino Zumalave (i cili më ndihmoi shume në ato kohe) më tha në telefon se kisha fituar, une në atë moment isha pa dritë në shtëpi. Shqipëria, si të gjithë vendet e lindjes pas rënies së Murit të Berlinit, po kalonte momentet më të vështira të tranzicionit. Megjithatë, u

vonova disa muaj për të ardhur në Spanjë. Nuk e di pse... Nuk e kisha të lehtë. Duhet të leja pas një bote për të hyrë në një tjetër. Në ato kohë, një profesor i im i vjetër tha "Do lesh pas një ferr për të gezueshëm dhe do gësh atje një parajsë për të trishtuar...". Por thenia e Mark Tuënit është me e bukur kur thote se Parajsa ka klimën e mirë por i pelqen më shumë Ferri prej shoqërisë.

P. Y. Shpesh më keni folur për ndryshimet rreth rrenjesore që kanë ndodhur në Shqipëri tuaj në këto vitet e fundit. Sa kanë ndikuar këto transformime shoqërore, kulturore dhe politike në muzikë që në fillim e deri sot?

F.V. Për fat të keq, historia e vendit tim nuk është e meritshme... Në këtë këndvështrim, ndryshimet në Shqipëri në këto dy dekadat e fundit pra, pas rënies së diktaturës komuniste, kanë qenë sa rrenjesore aq dhe dramatike. Siç ndodh shpesh në këto raste, në fillim kalohet nga një ekstrem tek tjetri me shumë lekundje e marrje mendsh deri sa, më në fund, gjendet ekuilibri. Dëçka e ngjashme me minoret që, kur dalin në sipërfaqe, duhet të mbrojnë sytë, po ashtu, vendit tim, drita verbuese e lirise i beri dëm në fillim... por tani është i shëruar.

Liria ishte gjeja e parë që u pasqyrua në të gjitha artet në përgjithësi dhe në muzikë në veçanti. Muzika më në fund ishte e lirë. U shëmben të gjitha tabutë e "diktaturës së tonalitetit", të atij romantizmi artificial, të parfumuar që, çuditërisht, u perpoqen të ruajnë të gjitha regjimet diktatoriale; si nazistet ashtu edhe Stalini e Mao e ndalonin "artin dekadent". E çuditshme kjo frikë ndaj artit të lirë, kjo kënaqësi perverse për kontroll absolut deri tek endrrat, si në librin që të le pa frymë *Pallati i Endrave* të Kadarsë. Ishin kohët e "Vellait të madh" të George Orwell por shumë më tepër të frikshme se ato të Telecinco sot (o pothuajse). Por kjo liri ka çmimin e saj si dhe një rrezik të fshehur që, siç pohon kompozitori i madh i ditëve tona, Helmut Lachenmann: "Ato parajsa që donim të pushtonim, papritmas, u kthyen në burgje".

P. Y. Në këtë panoramë që përshkruan, çfarë kompozitorësh mendon se duhet të njohim për të bërë një "harte" mëndore mbi muzikën bashkohore shqiptare?

F.V. Përpiqem të jem i informuar rreth muzikës së re në vendin tim, por nuk e kam të lehtë. Distanca të veshitërojnë gjerat. Por do të më pelqente të përmendja disa prej kompozitorëve më të cilet kam bashkëpunuar apo kam luajtur veprat e tyre për publikun spanjoll: Ballata, Buharaja, Ibrahim, Koci, Peçi, Rudi, Simaku, Shupo, Tole, Zacharian, Zadeja. Shumë prej tyre janë vlerësuar me tituj e çmime ndërkombëtare. Të gjithë janë zëra krejt të veçantë që formojnë një paisazh të pasur tingujsh në këtë vend të vogël të Adriatikut. Por kanë dëçka të përbashkët: muzika e tyre ka një bazë të mirë (shkolla ruse e gjysmës së parë të sh. XX), një mënyrë të shkruarit profesional bashkohor (tendencat e fundit përendimore) dhe, mbi të gjitha, shprehin ide dhe emocione gje që shpesh i mungon muzikës sot.



GISXX dhe Ema Andrea në Bienalën "Netet e Muzikës Klasike" Durrës 2009 (Stravinski, "Histoire du soldat")

P. Y. Besoj se një nga projektet e juaja më të dashura sot është festivali "Netet e Muzikës Klasike" që drejton në qytetin e Durrësit që nga viti 2003. Si lindi kjo inisiativë dhe në çfarë niveli ka arritur deri tani?

F.V. Bienalja "Netet e Muzikës Klasike" lindi në vitin 2003 në një formë krejt të natyrshme, në momentin dhe vendin e duhur, si të gjitha gjerat që duken si të parashkruara. Duke kaluar pushimet e verës në qytetin tim të lindjes, Durrës, mbledheshim çdo natë me miqtë e shkolles. Aty, në bisedat e pafundme, kujtimeve, birrave dhe humorit, luanim edhe kuintetet e e Mozart-it. Në ditët e fundit vendosem të luanim këto vepra të mrekullueshme

ne publik. Menjehere gjetem mbeshtetjen e bashkise si dhe te shume admiruesish te muzikes klasike. Vendosem nje emer te thjeshte, qe mund te ishte shume mire edhe "Netet e muzikes klasike ndermjet miqve dhe birrave te ftohta". Me ne fund festivali mori forme dhe u ndertua mbi nje strukture te mirefillte. Jane 7 nete me tematike te ndryshme, si nje promenade ndermjet epokave te muzikes duke perfshire edhe nje konkurs per talentet e reja. I gjithë cikli zhvillohet ne ambiente te veçanta qe nga teatri, muzeu, kisha apo nje klub e deri tek rrenojat e nje fabrike te braktisur ne periferi te qytetit.


Per çdo edicion porosisim nje veper premiere ndersa fituesi i konkursit te te rinjve ftohet nga Grupo Instrumental Siglo XX per koncerte ne Spanje. Po ashtu edhe Grupi luan rregullisht ne Bienale. Keshtu eshte krijuar nje "ure tinguish" ndermjet te dy vendeve.

Eshte kenaqesi e madhe te rikthehesh ne qytetin tend te lindjes dhe te besh muzike ndermjet miqsh dhe, ne te njejten kohe, ti kthesh diçka vendit tend, njerezve tuaj nga ajo qe te kane dhene...

P. Y. Perveç se violinist dhe drejtues, ju jeni dhe nje njeri i kulturuar ne kuptimin me te plote te kesaj fjale. Di qe keni formuar nje koleksion te rendesishem te pikturës shqiptare bashkohore si dhe qe ndiqni aktualitetin letrar te vendit tuaj. Nje pjese e kesaj dashurie per artin ju eshte dhene qe ne femijeri nga babai juaj, Gjergj Vlasi, shkrimtar, regjisor teatri dhe perkthyes. Çfare rendesie ka pasur kjo ne formimin dhe orientimin tuaj europian?

F.V. "Nga vi une? Vi nga feminia ime!" thote autori i *Princit* te vogel, Saint-Exupéry. Eshte e vertete qe feminia len nje gjurme te pashlyeshme tek ne dhe, me sa duket, personaliteti yt, rruga jote, fati yt formohet pak nga pak ne nje proces enigmatik ne çdo moment te atyre 4000 diteve te jetes tende ku perfshihet feminia.

Pavaresisht se duket kontradiktore per epoken e Luftes se Ftohte, une kam pasur nje femijeri te lumtur brenda dy boteve paralele; Ndersa ne Shkollen e Muzikes na jepnin nje edukim te mirefillte spartan instrumental, kur hyja ne shtepi ishte si te kaloje ne nje tjetere dimension... U rrita ne shtepine qe kishte biblioteken me te madhe te qytetit. Aty, ndermjet mijra librave ishin te gjithë, qe nga klasiket greke e deri tek "modernistet e ndaluar", qe nga albumet e pinakotekave te medha te artit klasik deri tek librat e Kandinsky-t apo Basquiat. Perveç mbi 250 disqeve te muzikes klasike qe kishim, im at regjistronte rregullisht koncertet e RAI-t bashke me premierat e veprave bashkohore.



Gjergj Vlasi tek biblioteka e shtepise ne Durres

Biblioteka... Per mua ishte e gjithë bota aty brenda. Luaja ndermjet librave duke bere figura me plasteline - loja ime e preferuar. Mama qe ishte mesuese, me mesoi organizimin dhe disiplinën. Te dy prindet me drejtonin me formulën magjike ne kete rruge "Shume disipline dhe shume dashuri por gjithmone duke luajtur". Im at na keshillonte mua dhe vellain tim Bepi (piktor) librat qe duhet te lexonim, na spjegonte pikturat kubiste te Pikasos apo readymade te Duchamp, qe me benin te qesh me urinoret e tij, me spjegonte permbajtjen e baletëve te Stravinskis si nje perralle... E gjithë kjo behej jashte ideologjise indoktrinuese te realizmit socialist sepse Arti i vertet ishte tjetere gje... "Nese eshte Art nuk eshte per te gjithë; nese eshte per te gjithë, nuk eshte Art".

Ne shtepine tone vinin shume muzikante, shkrimtare, aktore, miq te prinderve te mi, ndermjet tyre edhe Ismail Kadare (fitues i çmimit Principe de Asturias per Letersine 2009)

“Kjo shtepi eshte si Lidhja e shkrimtareve dhe e artisteve” thoshte ai. Edhe sot kujtoj ato mbremje me biseda interesante per Hemingway-n apo per artin e frikes ndersa shikonin deri ne mengjes ndeshjet e boksit ndermjet Cassius Clay dhe Joe Frazier...

Kur e mendoj tani them se, ne nje vend ku mbizoteronte mediokriteti i shtetit i cili ushtronte nje kontroll te hekurt mbi çdo gje, te hyje tek biblioteka ishte nje menyre per te ikur, per te emigruar, nje emigracion imagjinar, brenda teje...

Nuk e dinja atehere nese do te isha apo jo violinist por, isha i sigurte qe kisha hyre ne kete bote magjike te Artit per te mos dale kurre me... Ishte e domosdoshme per te jetuar (Oscar Wilde), per te mos vdekur nga e verteta (Nietzsche)

P. Y. Para pak ditesh keni interpretuar ne Vigo, me GISXX, *Kuartetin N1 “Métamorphoses nocturnes”* te György Ligeti, i shkruar ne Budapest ndermjet viteve 1953 dhe 1954 ku kompozitori hungarez thote se ka shprehur tensionin e tmerrshem qe realizmi socialist dhe stalinismi ushtronin ne ato momente historike. Kur punonit kete partiture me koleget e kuartetit, edhe ato vinin nga vendet ish komuniste, si influenconte e kaluara juaj ne percaktimin e ambientit te kesaj muzike?

F.V. Eshte nje veper madhore me nje ngjeshje dhe intensitet shkaterrues. Aty eshte çdo gje. Por eshte interesante qe, nen nje strukture klasike dhe te njohur, fshihet modernizmi. Tema kryesore eshte e ndertuar me dy intervale te secondes qe shkojne perpara, si dy hapa qe hedhim me shume frike ne nje truall te erret dhe te rrezikshem (kromatiket) ndersa Ligeti shkruan “Allegro grazioso”... Po ashtu tek Valsi qe, per ne eshte grotesk, lexojme “con elegancia” dhe nderkohe çdo gje shkatrohet nga nje valle popullore vulgare por me nje force e dhune ekstreme. Ne fund, mbi glisandot e harmonikeve, si mbi shpirtra ne ajer, shfaqet ne agoni motivi i temes kryesore tek violinat. Menjehere vjen tallja e vjoles qe, me ironi thote “Deshe te hedhesh nje hap perpara, apo jo?” Kjo mund te ishte ne ate kohe nje pyetje normale ne çdo zyre policie apo, akoma me keq, nje pyetje e unit tend, asaj pjeses tjetere qe quhet autocensura. Vetem ne masat e fundit Ligeti shkruan “dolente” dhe “morendo”... Te katert i kemi kuptuar shume mire keto kode pa folur thuaje fare per to. Çdo njeri prej nesh gjente aty fantazmat e vjetra...

Ne fund te koncertit Lilia Chirilov, e emocionuar, me thote “Jam e lumtur qe luajta kete veper... ishte aq e rendesishme per mua...” Ruslana Prokopenko nuk fliste. Vetem ndezi nje cigare. Ishte hera e pare qe e shikoja ta pinte...



F. Vlasi, tek biblioteka e shtepise ne A Coruña (Spanje) duke luajtur me violinen Moor te Andrés Gaos

P. Y. Dhe duke ardhur nga i gjithë ky bagazh kulturor dhe muzikor shqiptar, çfare gjen ketu kur mberrin ne A Coruña, si ne planin muzikor ashtu edhe ne ate social e kultural?

F.V. Libri i pare qe kam lexuar ne femijeri ishte *Fari ne fund te botes* i Jules Verne dhe, si nje paralajmerim i fatit, ketu jam, ne qytetin me farin me te vjeter te botes. Ketu gjeta nje dashuri te madhe per muziken, nje qytet i hapur ne te gjitha drejtimet si te gjithë qytetet bregdetare, te cilin e njoha me mire duke lexuar librat e Manuel Rivas si dhe duke luajtur Sonaten e Andrés Gaos - it dhe, ajo qe eshte me e rendesishme, u ndodha brenda nje orkestre te nivelit me te larte qe per mua u kthye shpejt ne familje te dyte.

Te dy femijet e mi, Daniel dhe Martin, u linden ketu dhe, bashke me time shoqe Redianen e cila po ashtu eshte violonçeliste nga Durrësi, jetojme ne nje shtepi plot me libra, piktura,

muzike dhe... nje kantine te pasur verash qe eshte perhere e hapur per miqte. Shtepia eshte ne nje kader te bukur qe per mua eshte si ne nje parajse te vogel. Ndermjet pemeve te limonave te kopshtit duken fari roman, oqeani dhe perendimet e diellit qe ketu nuk jane dy here njesoj.

Einstein thote se nje njeri per te qene i lumtur i duhet nje tavoline, nje karrige, nje shporte me fruta dhe nje violine. Une nuk jam dhe aq i sigurte per kete, te pakten do nderroja ndonje nga keto kater gjera. Por...çdo gje eshte relative.

Este artículo fue publicado el 04/02/2011